

RELACION PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9616, DATË 27.9.2006 "PËR LIBRIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" I NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i përgatitjes së Projektligjit të Librit është rishikimi i disa dispozitave të *Ligjit Nr. 9616, datë 27.9.2006 “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar*. Ky projektligj synon gjithashtu të pasqyrojë ndryshimet e ndodhura në fushën e librit, duke ju përgjigjur kontekstit aktual të zhvillimeve të teknologjisë dhe digjitalizimit në fushën e botimeve, të reflektojë ndryshimet në terminologjinë juridike, dhe të nxis aksesin e librit në çfarëdo forme, duke parashikuar jo vetëm kategoritë e veçanta por edhe duke garantuar aksesin nëpërmjet shpërndarjes së kopjeve të detyruara në institucione të tjera publike, përpos Bibliotekës Kombëtare.

II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji “Për Librin” në Republikën e Shqipërisë, është hartuar në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga programi i Qeverisë Shqiptare dhe angazhimeve të ndërmarra nga Ministria e Kulturës në kuadrin e hartimit dhe përmirësimit të akteve me fuqi ligjore dhe nënligjore i parashikuar në Planin Analitik të Projektakteve 2023.

Ministria e Kulturës është angazhuar në përgatitjen e këtij projektligji, në përputhje me fushën e veprimtarisë shtetërore që ka në kompetencë, si organ përgjegjës për hartimin dhe zhvillimin e politikave kombëtare në fushën e artit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Shtesat dhe ndryshimet në përmbajtjen e *Ligjit Nr. 9616, datë 27. 09 2006 “Për Librin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar*, vijnë si një domosdoshmëri e kohës dhe e përshtatjes me problematikat dhe format e zhvillimit të veprimtarisë botuese dhe procesin krijues në fushën e librit, por edhe në kuadër të nxitjes së botimeve por edhe garantimit të aksesit në libra, si një mekanizëm që ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e lexuesve në vend.

Projektligji synon:

- a) të promovojë librin dhe produktet e përafërta me të, në territorin e Republikës së Shqipërisë, jo vetëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë por edhe jashtë saj;
- b) parashikimin e institucionit përgjegjës për librin dhe leximin si Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit;
- c) përfshirjen e grupeve të interesit në KKLNL, e cila do të ketë në përbërje 4 ekspertë të fushës, nga të cilët 2 anëtarë përzgjidhen nga ministri përgjegjës për Librin dhe 2 anëtarë

nga grupet e interesit. Gjithashtu QKLL luan rolin e sekretariatit tekniko-administrativ në mbledhjet e Këshillit;

- d) parashikimin se fondi buxhetor i përvitshëm për blerjen e librave për bibliotekat publike të njësisive të vetqeverisjes vendore, është i patjetërsueshëm;
- e) lehtësimin nga numri i ekzemplarëve, të detyrueshme për Bibliotekën Kombëtare duke e reduktuar numrin e kopjeve nga pesë kopje në tre, dhe dorëzimin e dy kopjeve në institucione publike, me qëllim pasurimin e bibliotekave në funksion të nxitjes së leximit dhe lehtësimin e aksesit fizik për të gjithë lexuesit në nivel kombëtar;
- f) mekanizma të qartë për aksesin e personave me aftësi të kufizuara, duke parashikuar se në fondin kombëtar për librin, krahas nxitjes së botimit të veprave me rëndësi kombëtare, historike, kulturore e shkencore, i cili krijohet si zë më vete në buxhetin e ministrisë së Kulturës, është parashikuar një zë edhe për veprat të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuar.
- g) parashikimi i qartë lidhur me kontrollin për respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji, do të ushtrohet nga Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, pasi organi i parashikuar në ligjin aktual nuk ka tagër të ushtrojë inspektim dhe marrjen e masave administrative, në rast konstatimi shkelje. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi dhe ekzekutimi i masave administrative gjohet bëhet sipas legjislacionit në fuqi.

Lehtësimi i aksesit të personave me aftësi të kufizuara sa i përket librit është gjithashtu në përputhje me frymën dhe qëllimin e Direktivës së Bashkimit Europian të vitit 2019 “European Accessibility Act”.

Në këtë mënyrë, ligji parashikon kuadrin institucional për zbatimin e dispozitave të ligjit si dhe mekanizma të qartë në funksion të nxitjes së botimeve, rritjes së aksesit të qytetarëve, dhe respektimit të detyrimeve nga subjektet që operojnë në fushën e librit në Republikën e Shqipërisë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9616, datë 27.09.2006 ‘Për Librin në Republikën e Shqipërisë’”, është hartuar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, përkatësisht me nenet 78 dhe 83, pika 1.

Projektligji i paraqitur është në harmoni me gjithë rendin juridik të brendshëm.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BASHKIMIT EUROPIAN (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE

Ky projektligj nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me *acquis* e Bashkimit Europian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT.

Ky projektligj është i përbërë nga 18 nene.

Neni 1 parashikon në pikën 1, të nenit 1, pas fjalës "...përhapjen," shtohet fjala "leximin..", dhe pas togfjalëshit "...Republikës së Shqipërisë", shtohet fjala "...dhe jashtë saj."

Neni 2 riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

Objekti i këtij ligji është:

" a) përcaktimi i rregullave në fushën e prodhimit, botimit, ruajtjes, mbrojtjes, përhapjes dhe promovimit të librit e të produkteve të përafërta me të në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj;

"b) krijimi i kushteve për botimin e librave të autorëve shqiptarë në gjuhë të huaj dhe anasjelltas;

c) aksesin e personave me nevoja të veçanta në fushën e librit dhe leximit.

ç) zhvillimin e kulturës së leximit, promovimit të librit, autorëve.

d) promovimin e librit në formë digjitale.

2. Përcaktimi i rregullave në fushën e botimit, të prodhimit dhe shpërndarjes së librit shkollor bëhet me ligj të veçantë".

Neni 3 "përkufizime" bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 2, pas fjalës "... për fëmijë," hiqet togfjalëshi "...dëftuesit e hekurudhave ose të rrugëve detare, repertorët, që përmbajnë vetëm të dhëna numerike, repertorët alfabetikë" dhe pas fjalës "...e një kënge," hiqet togfjalëshi "fletoret e muzikës për detyra,"

2. Pika 3 riformulohet me përmbajtjen:

"Libër në formë elektronike është një botim libri, i përbërë nga tekst, imazhe ose të dyja, të lexueshme në pajisje elektronike.

3. Pika 4 riformulohet me përmbajtjen:

"4. Autor është çdo person fizik ose një grup personash fizikë, që krijon vepër letrare, artistike, shkencore, produkt intelektual origjinal, i materializuar, pavarësisht nga forma dhe mënyra e të shprehurit".

4. Në pikën 5, togfjalëshi "...106 të ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të." zëvendësohen me togfjalëshin "...127 të ligjit nr.35/2016, datë 31.03.2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to, i ndryshuar.

5. Pika 8 riformulohet me përmbajtjen:

"8. Librashitës është personi fizik ose juridik, që ushtron tërësisht ose pjesërisht, veprimtarinë e shitjes së librave në mjedise tregtare dhe tregje elektronike".

6. Pas pikës 11 shtohet pika 12 me përmbajtjen:

"12. Importues, është personi fizik ose juridik, që mundëson hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të materialeve të botuara, të shtypshkruara ose të prodhuara jashtë territorit".

Neni 4 parashikon ndryshimet në titullin e kreut III me përmbajtjen si më poshtë:

"INSTITUCIONET DHE ORGANET E LIBRIT DHE LEXIMIT"

Neni 5 parashikon ndryshimet në nenin 8 me përmbajtjen si më poshtë:

1. Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit,(në vijim QKLL) krijohet dhe funksionon si person juridik publik, buxhetor, me statusin e institucionit qendror, në varësi të Ministrisë përgjegjëse për librin.
2. Misioni i QKLL-së është ndjekja dhe zbatimi i projekteve në fushën e librit, duke synuar përhapjen e kulturës së leximit në të gjithë vendin, nxitjen e krijimtarisë, forcimin e rolit promovues dhe edukativ të bibliotekave, si dhe mbështetjen e projekteve për promovimin e letrave shqipe në tregun evropian dhe atë botëror”.
3. Kompetencat, mënyra e organizimit dhe funksionimit të QKLL-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6 parashikon ndryshime në nenin 9 si më poshtë:

1. Këshilli Kombëtar i Librit dhe i Nxitjes së Leximit (KKLNL) krijohet si organ këshillimor i Ministrisë përgjegjëse për librin dhe leximin për çështjet objekt të këtij ligji.
2. KKLNL jep rekomandime për hartimin e politikave e të programeve për promovimin e librit, nxitjen e leximit dhe veprimtarisë botuese në vend, për ruajtjen dhe mbrojtjen e traditës së librave të vjetër bukinistike, për rritjen e eksportit dhe përhapjen e librit shqip përtej kufijve shtetërorë.
3. KKLNL-ja ndihmon për organizimin e veprimtarive në fushën e librit, të panairove, ekspozitave, konkurseve dhe të veprimtarive të tjera kombëtare e ndërkombëtare, me pjesëmarrjen e autorëve, përkthyesve, botuesve dhe librashitësve shqiptarë e të huaj, si dhe sugjeron dhënien e çmimeve, veçanërisht për botimet e veprave me rëndësi kombëtare e në fushat që vlerësohen parësore për kulturën kombëtare.

Neni 7 parashikon ndryshimet në nenin 10, si më poshtë:

1. Në paragrafin e parë, pika 5 zëvendësohet me “Drejtorin e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit”.
2. Paragrafi i dytë riformulohet dhe numërohet pika 7 me përmbajtjen si vijon:
“7. Dy anëtarë personalitete të njohura të fushës, caktohen nga ministri përgjegjës për librin për një periudhë 4-vjeçare dhe dy përfaqësues nga grupet e interesit”.

Neni 8 parashikon ndryshime në nenin 11 si më poshtë:

1. “Mënyra e funksionimit dhe organizimit të KKLNL-së përcaktohet me urdhër të Ministrisë përgjegjëse për politikën e librit dhe leximit.
2. “Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit shërben si sekretari tekniko-administrativ në mbledhjet e KKLNL-së”.

Neni 9 parashikon ndryshime dhe shtesa në nenin 12 si më poshtë:

1. Pas togfjalëshit “...kulturore dhe shkencore” shtohet togfjalëshi “...dhe veprave të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara.
2. Pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë me përmbajtjen si vijon:
“2. Procedurat, kushtet, kriteret dhe masa e bashkëfinancimit të titujve të veprave të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, pas propozimit të ministrit përgjegjës për librin dhe ministrit përgjegjës për çështjet sociale”.

Neni 10 parashikon në nenin 13 të shtohet paragrafi 2 me përmbajtjen si më poshtë:

“2. Përcaktimi i kushteve, kriterëve dhe procedurave për dhurimin e 2 (dy) kopjeve të detyruara të dorëzuara pranë Bibliotekës Kombëtare, kur nga dorëzimi kanë kaluar 10 (dhjetë) vite bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave” .

Neni 11 parashikon ndryshime në nenin 17 si më poshtë:

1. Pika 2 riformulohet me përmbajtjen si më poshtë;

“Këshillat bashkiakë planifikojnë dhe përcaktojnë në buxhetet vjetore respektive një zë të veçantë për blerjen e librave për bibliotekat publike të njësive të vetëqeverisjes vendore.”

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtjen si më poshtë:

“3.Fondi për librin, i miratuar në buxhetin e organit qendror apo vendor është i patjetërsueshëm.”

Neni 12 parashikon ndryshime në nenin 19 si më poshtë:

Emërtesa *“Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve...”* zëvendësohet me emërtesën: *“Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit...”*.

Neni 13 parashikon ndryshime në nenin 21, si më poshtë

Pas germës “k” shtohet germa “l” me përmbajtjen si vijon:

“l.Identifikuesi Unik Universal (UUID) me 32 karaktere i cili përbëhet nga tre komponente:

- i. Adresa e rrjetit për të identifikuar ku është hostuar materiali;*
- ii. Koha e stampimit, publikimit, për të identifikuar kur është postuar materiali;*
- iii. Komponenti i gjeneruar rastësisht, si një e dhënë ekstra e elementëve unikë.*

Neni 14 parashikon shfuqizimin e nenit 32

Neni 15 parashikon në nenin 35 paragrafi i dytë riformulohet me përmbajtjen si vijon:

“Kontrolli për respektimin e këtij detyrimi ushtrohet në bazë të ligjit nr.10433 datë 16.10.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Neni 16 parashikon ndryshimet dhe shtesat në nenin 42 si vijon:

1. Togfjalëshi *“...njësive administrative vendore...”* zëvendësohet me togfjalëshin *“...njësive të vetëqeverisjes vendore...”*

2. Pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë me përmbajtjen si vijon:

“2.Biblioteka Kombëtare mban detyrimisht tre kopje nga pesë botimet e dorëzuara dhe shpërndan kopjet e tjera në institucionet publike në bazë marrëveshje të nënshkruar mes palëve dhe miratim nga ministri përgjegjës për librin”.

3. Pas paragrafit të dytë shtohet paragrafi i tretë me përmbajtjen si vijon:

“3.Për librin në formë elektronike , botuesi dorëzon kopje në formën përkatëse pranë Bibliotekës Kombëtare në bazë të nënshkrimit të një marrëveshje mes palëve.

Neni 17 parashikon ndryshime në nenin 48 si më poshtë:

1. Germat “b” dhe “dh” shfuqizohen.

2. Pikat 2 e nenit 48 riformulohet me përmbajtjen si vijon:

“2. Masat administrative gjobë jepen nga Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut”

3. Pika 3 riformulohet si më poshtë:

“3. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi dhe ekzekutimi i vendimeve bëhet sipas legjislacionit në fuqi”.

Neni 18 parashikon se në të gjithë përmbajtjen e ligjit togfjalëshat *“Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve...”* dhe *“Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve”* zëvendësohen me togfjalëshat *“Ministri përgjegjës për politikën e librit dhe leximit”* dhe *“Ministria përgjegjëse për politikën e librit dhe leximit”*.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT.

Projektakti parashikon se për zbatimin e tij ngarkohet Ministria e Kulturës, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, Biblioteka Kombëtare, bibliotekat publike dhe organet e vetqeverisjes vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT

Ky projektakt është hartuar nga Ministria e Kulturës, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit.

Para hartimit të projektligjit, Ministria e Kulturës i është drejtuar me shkresë zyrtare institucioneve dhe grupeve të interesit si vijon: Aleancës së Librit Shqip; Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; Institutit të Statistikave; Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë; Shoqërisë së Librit Shqip; Shoqatës së Botuesve Shqiptar.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektligji nuk shoqërohet me kosto financiare shtesë për buxhetin e shtetit, por nga ekzekutimi i masave administrative gjobë mund të gjenerohen të ardhura.

MINISTRI

ELVA MARGARITI